

Data / /2024

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

STUDIM PROJEKTIM “Rikonstuksion i godines se Zyrave te TP”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kodi CPV: 72242000-3 - Shërbimet e modelimit të projekteve,

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,945,449.00 (nje milion e nentëqind e dyzete e pese mije e katerqind e dyzete e nente) **lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të V.K.M-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Tirana Parking**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 12*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 5;*

c. *Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të V.K.M-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

a. Sipas pikes 1 te shtojces 11 (Kriteret e Pergjithshme per Kualifikim).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë sepse ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për tre vitet e fundit financiare (2021, 2022, 2023), të konfirmuara nga Administrata Tatimore, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në nenin 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 date 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar.

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga pushteti vendor për vitin 2024 sipas afateve të maturuara/përcaktuara dhe parashikuara në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lëshuar prej njësisë të vetëqeverisjes vendore ku operatori ekonomik ka selinë. Ky kriter plotësohet me paraqitjen e vetedeklarimit në fazën e ofertimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e TaksaveVendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar.

Shënim: Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit .Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit,të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarin e mësipërm.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përllogaritur të kontratës

- Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b të V.K.M-së nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën që AK kërkon të realizojë

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me

kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në afat dhe me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme është një “kompetencë thelbësore”, ndaj operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për ta provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Liçensa profesionale të operatorit ekonomik (e vlefshme) për projektim (lëshuar nga MZHUT ose nga Institucioni i Autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studimit e projektimit në ndërtim), ku të përfshihen kategorite:

2. PROJEKTUES ARKITEKT

- a-Projektim arkitekturor për objekte banimi –objekte industriale-objekte turistike
- d- Projektim peisazhi, sistemim sipërfaqe te gjelberta, lulishte e parqe.

3. PROJEKTUES KONSTRUKTOR

- a) Projektim objekte civile - industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.
- d) Vlerësimi i kapacitetit mbajtës dhe perforcimi i strukturave mbajtëse prej beton-arme, murature dhe metalike.

4. PROJEKTUES INSTALATOR

- a) Projektim te instalimeve hidro-termosantare;
- b) Projektim te instalimeve termoteknike- kondicionimi, si dhe te impianteve te prodhimit te energjise termike nga burime te rinovueshme
- c) Projektim te linjave e rrjeteve elektrike, per objekte civile e industriale;
- f) Projektim te sistemeve kundra zjarrit.;
- i) Projektimi i ndriçimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndriçim të objekteve të mëdha sportive, porteve, aeroporteve;
- j) Projektim te rrjeteve te telefonise, citofonise, fonise, internetit, TV, access kontroll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit te zjarrit, etj., per objektet civile dhe industriale.

5. PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE

- b) Projektim furnizim me ujë – kolektorë shkarkimi.
- c) Projektim ujsjelles kanalizime urbane -rurale

8. PROJEKTUES GJEODET

- a) Rilevime inxhinierike
- d) Bazamente gjeodezike

9. STUDIM GJEOLOGO INXHINIERIK - HIDROGJEOLOGJIK

- a) Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile – ekonomike deri 5 kate.
- d) Studim/ vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve te buta

10.PROJEKTIMI I IMPIANTËVE TË PRODHIMIT DHE SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE

- c) Impiante të prodhimit të energjisë elektrike të rinovueshme, diellore etj.
- e) Projektim kabina elektrike të rrjetit shpërndarës – linja të tensionit të ulët – të mesëm.

(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).

*Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë **Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (leshuar nga MZHUT ose institucione të tjera të autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e liçensave profesionale në fushën e studim projektimit në ndërtim), e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.***

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet te ketë ne Licensen e Shoqerise stafin si më poshtë dhe te jenë te perfshirë ne listpagesën e shoqërisë për tre muajte e fundit te deklaruar:

- Min 1 (një) Arkitekt/Urbanist;
- Min 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- Min 1 (një) Inxhinier Hidroteknik;
- Min 1 (një) Inxhinier topograf/gjeodet
- Min 1 (një) Inxhinier Gjeolog
- Min 1 (një) Inxhinier Elektrik;
- Min 1 (një) Inxhinier Mekanik;

Per stafin e mesiperm Operatori Ekonomik duhet te paraqese:

Kontratat individuale te punes (të vlefshme), Licencat profesionale, Diplomë .

Një projektues nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.

Stafi i angazhuar të paraqesë shtojcen 7 deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

***Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.*

Konkretisht:

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për shërbimin e mbikqyrjes se punimeve te zbatimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të shërbimit. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të

patur një rezultat sa më të mirë në hartimin e projektit. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje për muajin e fundit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën me sukses. Staf i kosnulent është përgjegjës për kryerjen e shërbimit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

Shënim: Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit .Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit,të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarin e mësipërm.

2.3.4 Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë si staf në listpagesa tre muajte e fundit si më poshtë:

- 1 (një) inxhinier ndërtimi
- 1 (një) inxhinier elektrik/ Elektronik/ Telekomunikacion/IT
- Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor kontratë të vlefshme pune dhe dëshmi të kualifikimit profesional/diploma/certifikata trajnimi nga një organizëm i akredituar/licencuar /certifikuar shqiptar ose i huaj për 1 (një) ekspert që përmbush kriteret për të qenë koordinator në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizimit të punimeve, sipas kërkesave të ligjit nr. 10237 date 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M. nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, i cili të figurojë në listpagesat e shoqërisë për muajin e fundit.
- Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor kontratë të vlefshme pune dhe dëshmi të kualifikimit profesional/diploma/certifikata trajnimi nga një organizëm i akredituar/licencuar /certifikuar shqiptar ose i huaj për 1 (një) ekspert që përmbush kriteret si Ekspert Privat Zjarrfikës, në përputhje me klauzolat e Ligjit nr. 152/2015 datë 21.12.2015 "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin", i cili të figurojë në listpagesat e shoqërisë për tre muajte e fundit.

Per punonjësit e mesiperm Operatori Ekonomik duhet të paraqese:

Kontratat individuale të punës (të vlefshme), Diplomë, CV

Një projektues nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.

Stafi i angazhuar të paraqesë shtojcen 7 deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht:

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për shërbimin e mbikqyrjes së punimeve të zbatimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të shërbimit. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në hartimin e projektit. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje për muajin e fundit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën me sukses. Stafit kosnulent është përgjegjës për kryerjen e shërbimit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

Shënim: Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit .Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit,të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.Autoriteti Kontraktor rezervon të drejten të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarin e mësipërm

2.3.5 Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij të paktën **13 (trembëdhjetë) punonjës** për tre muajt e fundit të deklaruar, të vërtetuar me:

- a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për periudhen e fundit të deklaruar
- b) Listpagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per per periudhen e fundit të deklaruar.

Shënim: Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit .Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit,të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.Autoriteti Kontraktor rezervon të drejten të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarin e mësipërm.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Shënim: Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit .Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit,tëgjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarin e mësipërm.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të jete i pajisur dhe të paraqese Certifikatat te pershtatshme ose ekuivalentet e tyre per objektin e prokurimit si me poshte:

- a) ISO 9001: 2015, Per menaxhimin e cilesise;
- b) ISO 14001: 2015, Per menaxhimin e cilesise se mjedisit;
- c) ISO 45001-2018 . Sistemi i Menaxhimit për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë;
- d) ISO 50001-2011, Sistemi i Menaxhimit të Energjisë;
- e) ISO 39001- 2012 Studim, projektim i objekteve civile industriale
- f) ISO 3834-2: 2021 Studim, projektim i objekteve civile industriale

Shënim: Në rastet e Bashkimit te Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqese certifikatën e mësipërme në bazë të zërave të marrë përsipër të realizoje sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ”Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.”si dhe pika 1, neni 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar ku citohet: .Autoriteti enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

Për vete natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët të kryejnë shërbimet dhe realizojnë objektin e kontratës me standardet e kërkuara të cilësisë.

2.3.7 Operatori Ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera:

- *1(një) Pajisje GPS*

Në lidhje sa më sipër operatori ekonomik duhet të paraqesë: Faturë shitblerje ose kontratë qeraje të noterizuar (shoqëruar me dokumentat e pronsisë së qiradhënësit origjinal ose fotokopje e noterizuar) si dhe skedën teknike.

- *1(një) Pajisje Total Station*

Në lidhje sa më sipër operatori ekonomik duhet të paraqesë: Faturë shitblerje ose kontratë qeraje të noterizuar (shoqëruar me dokumentat e pronsisë së qiradhënësit origjinal ose fotokopje e noterizuar) si dhe skedën teknike.

- *1(një) Automjet*

Për automjetet kur janë në pronësi të paraqetet çertifikata e pronësisë, siguracioni, certifikata e kontrollit teknik. Për automjetet me qera të paraqitet kontrata noteriale e qerasë, siguracioni i automjetit, çertifikata e kontrollit teknik.

Shënim: Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit .Operatori ekonomik i kualifikuar i pari ne klasifikim duhet te dorezojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit,tëgjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.Autoriteti Kontraktor rezervon të drejten të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarin e mësipërm.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Mjetet e mesiperme jane vendosur ne perputhje me natyren e

Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, pajisjet topografike e asete të tjera fizike, aftësitë organizative etj. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

- Operatori ekonomik ofertues në përlogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik ”Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet te jete brenda kufijve te vleres minimale dhe maksimale te lejuar ne kuptim te nenit 7/1 te VKM nr 354,datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim”.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike/preventivi/dokumentacioni i nevojshëm, janë vendosur në bazë të, nenin 4,pika 7, 38, nenin 36 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenin 40, pika 2, të V.K.M-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.